



Buletini i Turizmit

Raportim Mujor
Janar 2023

PËRMBAJTJA

HYRJE

- 1. VIZITORË TË HUAJ TË HYRË PËR MUAJIN JANAR 2023..... fq.3**
 - 1.1. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**
 - 1.2. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve**

- 2. TURIZMI KULTUROR.....fq.5**

- 3. TURIZMI NATYROR..... fq.7**

1. HYRJET E VIZITORËVE TË HUAJ PËR MUAJIN JANAR 2023

Në Janar 2023, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 377.211. Ky numër është rritur me 94,2 %, krahasuar me Janar 2022

Periudha	Janar 2021	Janar 2022	Janar 2023	Ndryshimi në (%)
Vizitorët e huaj	185,329	194.237	377.211	94,2 %,

1.1. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Referuar qëllimit që deklarojnë shtetasit e huaj, që vizitojnë Shqipërinë, rezulton se gjatë muajit të parë të vitit kanë hyrë 360,439 “turistë”, që janë vizitorët që shpenzojnë më shumë se një natë brenda territorit Shqiptar. Siç vihet re kemi një ulje për vizitorët që vijnë për qëllime shëndetësore dhe fetare.

Më poshtë është tabela e vizitorëve të huaj sipas qëllim të vizitës së tyre, që deklarojnë në pikat tona kufitare:

Periudha	Janar 2021	Janar 2022	Janar 2023	Ndryshimi në (%)
Gjithsej	185.329	194.237	377.211	94,2
I. Personale	179.183	188.031	369.606	96,6
Pushime, miq e të afërm. Te tjere	169.073	179.971	352.752	96,0
Qëllime fetare	44	29	21	-27,6
Qëllime shëndetësore	137	135	115	-14,8
Tranzit	9.929	7.896	16.718	111,7
II. Biznes dhe profesionale	6.209	6.206	7.605	22,5

Burimi INSTAT

1.2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shtetësisë

Në janar 2023, vihet re se shtetasit me shtetësi kosovare kanë një rritje tre shifrore, krahasuar me të njëjtin muaj të vitit paraardhës. Nga tabela vihet re se ka rritje për shtetasit nga vendet fqinje me ne. Gjithashtu ka një rritje të vizitorëve nga,

Ukraina dhe Turqia, që edhe pse nga këto vende numri i përgjithshëm hyrës nuk ka peshë të rëndësishme kundrejt totalit të shtetasve të huaj të hyrë.

Më poshtë gjeni tabelën e hyrjes së vizitorëve të huaj për nga shtetësia:

	Janar 2021	Janar 2022	Janar 2023	Rritja në % krahasuar me 2022
KOSOVË	87,690	63,367	166,332	162%
MAQEDONIA E VERIUT	34,293	32,558	43,590	34%
GREQI	5,018	18,961	35,129	85%
ITALI	9,929	21,281	35,610	67%
ANGLI	1,549	4,586	6,498	42%
MALI I ZI	24,214	21,330	39,709	86%
POLONI	223	470	864	84%
SHBA	1,954	3,622	5,498	52%
GJERMANI	2,952	3,517	5,019	43%
ZVICËR	2,394	1,585	2,026	28%
FRANCA	1,269	1,494	2,071	39%
AUSTRI	553	798	1,087	36%
TURQI	2,002	3,703	8,295	124%
BULLGARI	984	1,568	2,052	31%
KROACI	1,024	1,482	1,879	27%
RUMANI	510	775	1,087	40%
UKRAINË	370	495	1,716	247%
BOSNJE-HERCEGOVINË	901	942	1,308	39%
SERBI	2,592	2,814	3,539	26%
HOLLANDË	245	561	920	64%
SUEDI	286	385	724	88%

NORVEGJI	110	228	178	-22%
-----------------	-----	-----	-----	------

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit

2. TURIZMI KULTUROR

Për Janar 2023, kemi një rritje prej 18% të vizitorëve në institucionet tona kulturore krahasuar me muajin e parë të vitit të shkuar. Më poshtë po japim tabelën e vizitueshmërisë së institucioneve të kulturës në muajin janar në tre vitet e fundit.

Nr.		EMËTIMI I INSTITUCIONIT			
		Janar 2021	Janar 2022	Janar 2023	Ndryshimi në %
1	MUZEU HISTORIK KOMBËTAR TIRANË	0	355	1,578	345%
2	MUZEU ARKEOLOGJIK DURRËS	76	164	0	-100%
3	MUZEU I PAVARSISË VLORË	38	17	122	618%
4	MUZEU GJERGJ KASTRIOTI, KRUIJË	918	1,366	1,835	34%
5	MUZEU ETNOGRAFIK, KRUIJË	204	223	0	-100%
6	MUZEU ETNOGRAFIK BERAT	61	153	0	-100%
7	MUZEU IKONOGRAFIK ONUFRI, BERAT	171	448	1,140	154%
8	MUZEU I ARTIT MESJETAR, KORÇË,	102	177	394	123%
9	MUZEU ARKEOLOGJIK, KORÇË,	25	9	87	867%
10	MUZEU ARSIMIT, KORÇË,	0	569	782	37%
11	MUZEU K. I FOTOGRAFISË MARUBI	169	210	414	97%
12	MUZEU K. I PËRGJIMEVE " SHTËPIA ME GJETHE"	293	616	970	57%
TOTALI MUZE		2,057	4,307	7,322	70%
1	KALAJA BERAT	827	3,835	0	-100%
2	KALAJA GJIROKATËR	503	787	2,670	239%
3	KALAJA PORTOPALERMOS	6	8	14	75%

4	KALAJA E KANINËS	3	10	0	-100%
5	KALAJA E HIMARËS	0	8	0	-100%
6	AMFITEATRI	38	144	195	35%
7	MANASTIRI I 40 SHËNJTORËVE	0	2	5	150%
TOTALI KALA E MONUMENTE TE TJERE		1,377	4,794	2,884	-40%
1	PARKU KOMBËTAR BUTRINT	183	385	430	12%
2	PARKUT ARKEOLOGJIK APOLONI	133	674	1,551	130%
3	PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS	133	136	109	-20%
4	PARKU ARKEOLOGJIK SHKODËR	1,450	2,339	2,581	10%
5	PARKU ARKEOLOGJIK LEZHË	75	187	162	-13%
6	PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA	15	1	4	300%
7	PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM	56	4	35	775%
8	PARKU ARKEOLOGJIK FINIQ	0	-	16	-
9	PARKU ARKEOLOGJIK ANTIGONE	0	-	31	-
TOTALI PARQE ARKEOLOGJIK		2,045	3,726	4,919	32%
TOTALI NUMRI I VIZIOREVE		5,479	12,827	15,125	18%

Burimi: Ministria e Kulturës

Në lidhje me të ardhurat nga vizitorët në Institucionet Kulturore për këtë muaj rezultojnë që të jenë përfituar rreth 4,380,620 lek, ose 11,7% më shumë se të ardhurat e përfituara në Janar të vitit 2022.

3 TURIZMI NATYROR


Të dhënat nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, tregojnë se gjatë muajit Janar 2023 janë 93,975 vizitorë shqipëtar dhe të huaj që kanë vizituar zonat tona të mbrojtura. Rezulton se kemi një ulje të numrit të vizitorëve gjatë këtij muaji të parë të vitit në vlerën 41%. Më poshtë po japim të dhënat në tre vitet e fundit për muajin Janar.

QARKU	JANAR 2021	JANAR 2022	Janar 2023	NDRYSHIMI NE %
Tirana	7,764	7,328	9,028	23%
Vlora	10,118	10,803	8,130	-25%
Lezhë	2,332	3,764	5,295	41%
Gjirokastrë	839	1,806	3,626	101%
Kukës	700	1,025	315	-69%
Korçë	90,570	100,408	14,065	-86%
Berat	263	1,307	1,533	17%
Elbasan	2,294	3,001	2,461	-18%
Shkodër	1,880	7,000	12,510	79%
Dibër	63	306	6,412	1995%
Fier	13,000	12,700	18,000	42%
Durrës	14,300	11,050	12,600	14%
TOTALI	144,123	160,489	93,975	-41%


Burimi: Agjensia e Zonave të Mbrojtura

Për të parë se cilat kanë qënë Zonat e Mbrojtura më të vizituara gjatë muajit janar po e japim me paraqitje grafike sipas kategorive.

Kategoria e **Parqeve Natyrore** ka 12 zona të cilat janë vizituar nga 42,100 vizitorë, prej tyre 88% janë vizitorë vendas dhe 12% vizitorë të huaj. Numri më i madh i vizitorëve për këtë kategori është në Parkun Kombëtar të Divjakës- Karavasta (36%) dhe e dyta për nga vizitueshmëria është në Alpet e Shqipërisë nga pjesa e Shkodrës.




Në kategorinë **Monumentet e Natyrës**, janë të shpallura 30 zona, të cilat gjatë janarit ka pasur vizitorë vetëm në 18 prej tyre zona të cilat janë vizituar prej 12,141 vizitorë. Nga këta 91% janë vizitorë vendas dhe 9% vizitorë të huaj. Vizitorët me numrin më të madh janë në Monumentin e Natyrës Sarisalltik të Krujës (34% e vizitorëve), e cila ndiqet nga Shpella e Shënandoit (21%) dhe Ujërat Termale të Bënjës(18%). Më poshtë po japim në mënyrë grafike numrin e vizitor në grafikun më poshtë:




Në kategorinë **Rezervatet Natyrore të Menaxhuar dhe Parqet Natyror** Monumentet e Natyrës janë të përfshira 24 zona, por vetëm në 17 prej tyre ka pasur vizitorë për muajin janar 2023. Numri i vizitorëve për muajin shtator për këtë kategori është 20,750, nga këta 91% janë vizitorë shqipëtar. Numrin më të madh

nga Kune Vaini (16%) dhe Mali me Gropa (16%).



Në kategorinë **Peisazh I Mbrojtur** përfshihen 11 zona, por për muajin janar, ka pasur vizitor vetëm në 7 zona. Numri i vizitorëve që kanë vizituar këto 7 zona është 18,982, nga ku 86% e vizitorëve janë shqiptarë. Vizitorët me numrin më të madh janë në Peisazhin e Mbrojtur të Liqenit të Pogradecit, të ndjekur nga vizitorët në Lumin e Bunës dhe në Nartë Pishë Poro.



Sipas Agjensisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të ardhurat, për zonat ku vizitorët paguajnë, për muajin Janar llogaritet që është përfituar një vlerë prej 235,400 Lek vihet re një ulje e të ardhurave prej 39,4 % krahasuar me muajin janar 2022.